

KOMUNITETI I TË NXËNIT DEMOKRATIK DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Manual për trajner



Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

KOMUNITETI I TË NXËNIT DEMOKRATIK DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Manual për trajner

Riprodhimi i pjesëve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, përveç për qëllime komerciale, për derisa rruhet origjinaliteti i tekstit, pjesët nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk ofron informacion të pakompletuar apo nuk e keqinformon lexuesin në ndonjë mënyrë tjetër sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Burimi i tekstit duhet gjithmonë të përmendet, si në vijim “© Këshilli i Evropës, viti i publikimit”. Të gjitha kërkesat e tjera përkitazi me riprodhimin/përkthimin e të gjitha ose disa pjesëve të dokumentit duhet të drejtohen tek drejtorja e komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex or publishing@coe.int).

Dizajni dhe faqosja: Departamenti i prodhimit të dokumenteve dhe publikimeve (DPDP), Këshilli i Evropës

Burimi i fotografive: Shutterstock dhe projekti INCLUDE

Ky publikim nuk është edituar nga Njësia editoriale e DPDP për të korrigjuar gabimet e shtypit apo ato gramatikore.

© Këshilli i Evropës, Gusht 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Licensuar nga kushtet e Bashkimit Evropian.

Shtypur nga Këshilli i Evropës


Përgatitur nga Rolf Gollob

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “INCLUDE – Ndërtimi i kapacitetit për Arsim Gjithëpërfshirës” me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Opinionet e shprehura këtu nuk mund të asnjë mënyrë të merren si pasqyrim i opinionit të asnjëres palë.

Përmbajtja

PJESA I: INFORMATA TË PËRGJITHSHME	5
Hyrje	6
Grupi i synuar	6
Parakushtet	6
Metodologjia	6
Rezultatet përfundimtare të të nxënit	7
Aspektet e përgjithshme	7
Përmbledhje e programit	7
PJESA II: PLANET E TRAJNIMIT	9
PUNËTORIA 1:	
HYRJE, NDËRTIMI I EKIPIT DHE PROFILI I SHKOLLËS GJITHËPËRFSHIRËSE	10
PUNËTORIA 2:	
REFLEKTIMI I ROLIT TË MËSIMDHËNËSIT NË GJITHËPËRFSHIRJE DHE TEMA E BULLIZMIT	13
PUNËTORIA 3:	
BULLIZMI DHE GJITHËPËRFSHIRJA NË PRAKTIKË	18
PUNËTORIA 4:	
PRAKTIKA E MËSIMDHËNIES E DUKSHME PËRMES MËSIMDHËNIES SIMULUESE	22
PJESA III: KUTIA E MJETEVE E TRAJNERËVE	25
SI TË MBËSHTET ZBATIMI I PËRFSHIRJES NË MËSIMDHËNIEN E PËRDITSHME?	26
Bazat për praktikën e mësimit në mësimdhënie të përditshme	26
Koncepte për të mbyllur boshllëqet e mësimit në mësimdhënie të përditshme	29
për Romë, Ashkali dhe Egjiptianë pas Covid-19	29
KOMPETENCAT SI QËLLIM I EDUKIMIT DHE ARSIMIMIT	30
Cilat janë kompetencat?	30
Cilat janë kompetencat për një qytetari demokratike?	30
ZBATIMI I TAKSONOMISË SË BLOOM-IT NË TË GJITHA TRAJNIMET	32
VIZITA TEK MËSIMDHËNËSIT: VËZHGIMI DHE DHËNIA E INFORMATAVE KTHYESE	34
TRAJNIMI DHE PLANIFIKIMI I KOMPETENCAVE PËR KULTURË DEMOKRATIKE (KKD)	40
Si të organizohet procesi i mësimit në mësimdhënie të përditshme	40
Parimet e planifikimit	41
Metodat/qasjet	41
REFLEKTIMI I ROLIT TË TRAJNERËVE	47
Kultura e demokracisë: Poster i kopshtit.	48

PJESA I: INFORMATATË PËRGJITHSHME



HYRJE

Ky manual i trajnerëve është një shtesë e manualit për mësimdhënësit pjesëmarrës ('Brenda - Njohuri - Gjithëpërfshirje'). Pjesa më e madhe e përmbajtjes mësimore dhe informacionit të specializuar për temat e gjithëpërfshirjes, kulturës demokratike, bullizmit dhe edukimit mjedisor janë përgatitur në mënyrë të tillë që ato të vlejnë si materiale për punëtoritë, si dhe për mësimet e mësimdhënësve.

Qëllimi është që pjesëmarrësit të punojnë me manualin e tyre deri në fund të kursit. Fokusi nuk është aq shumë në prezantimet e trajnerit sesa në leximin e vetë pjesëmarrësve gjatë dhe midis punëtorive.

Pas çdo punëtorie, pjesëmarrësit kanë detyra të shtëpisë, të cilat bëhen përmbajtja e parë nga katër sesioneve në fillim të punëtorisë tjetër.

Çdo punëtori është strukturuar në katër seanca me nga 1.5 orë secila. Trajnerët me përvojë përfundojnë seancat në kompetencat e veta. Ata i njohin pjesëmarrësit dhe se si ata mund të inkurajohen të mësojnë aktivisht.

Që nga fillimi, trajnerët vizitojnë pjesëmarrësit ndërmjet punëtorive. Për vëzhgimin përkatës të mësimit dhe informatat kthyes të detyrueshme dhe cilësore, derivatet mund të gjenden në këtë manual.

GRUPI I SYNUAR

Faza e parë e trajnimit pesë-pjesësh ka për qëllim mësimdhënësit e shkollave të përzgjedhura. Mësimdhënësit përkatës punojnë në ekipe shkollore (rreth 10 për shkollë) dhe shoqërohen dhe trajnohen nga trajnerë të trajnuar posaçërisht.

PARAKUSHTET

Mësimdhënësit pjesëmarrës duhet të:

- ▶ jenë në dispozicion për të marrë pjesë në 4 sesione trajnimi një-ditore dhe në fazat e përfshira të zbatimit mes tyre;
- ▶ jenë të motivuar dhe të angazhuar për të eksperimentuar me metoda të reja të mësimdhënies dhe t'i zbatojnë aktivitetet bazuar në përvojën e trajnimit.

METODOLOGJIA

Trajnimi karakterizohet nga një përzierje e ekuilibruar e njohurive, vlerave dhe shkathtësive. 'Manuali për Mësimdhënësit' është në qendër të zhvillimit të njohurive dhe formon bazën e të gjitha njësive të trajnimit. Në vend të paraqitjeve të njohurive të gjera, pjesëmarrësit do të marrin detyra leximi gjatë ditëve të trajnimit dhe do të diskutojnë (çiftëzojnë) njohuritë e fituara (mendojnë) me kolegë profesionistë dhe t'i ndajnë ato me të tërë grupin e trajnimit (ndajnë). Trajnerët sigurohen që secila detyrë e leximit të jetë e bazuar në detyra, d.m.th. të jetë e kombinuar me detyra njohurish dhe zbatimi. Taksonomia e Blooms-it do të përdoret rregullisht.

Metodologjia e përdorur gjatë trajnimit paraqet një përzierje të:

- ▶ Leximit/punës individuale
- ▶ Punës në çifte/grupe
- ▶ Seancave plenare
- ▶ Ligjëratave dhe prezantimeve
- ▶ Ushtrime ndërvepruese, të cilat, për pjesën më të madhe, mund të përsëriten ose përshtaten për t'u përdorur me nxënës

Metodat dhe aktivitetet ndërvepruese të cilat stimulojnë reflektimin, bashkëpunim dhe kreativitetin do të jenë të privileguara gjatë gjithë kohës së trajnimit. Kjo hapësirë ofrohet në sesionin e fundit të trajnimit për t'u përgjigjur nevojave të veçanta shtesë të shkollave individuale, sa i përket adresimit të temave të tjera të ndërlidhura ose thellimit në ato tashmë të adresuara në sesionet e mëparshme).

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË TË NXËNIT

Pas përfundimit të kursit, mësimdhënësit pjesëmarrës do të jenë në gjendje të:

- ▶ kuptojnë natyrën komplekse dhe holistike të gjithëpërfshirjes
- ▶ shpjegojnë kolegëve dhe prindërve profesionistë se cilat parime duhet të ndjekin në mënyrë që të dizajnojnë një shkollë gjithëpërfshirëse dhe të zbatojnë mësimdhënien gjithëpërfshirëse
- ▶ zbatojnë parimin e mësimdhënies gjithëpërfshirëse në praktikën e përditshme dhe të vlerësojnë rezultatet në mënyrë të pavarur
- ▶ pasqyrojnë qëndrimin e vet ndaj gjithëpërfshirjes dhe diversitetit dhe kanë krijuar profilin e vet përkatës të përparësive-dobësive
- ▶ njohin KRRKD-në dhe sa të rëndësishme janë 20 kompetencat për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, si dhe për zhvillimin demokratik në shkolla dhe shoqëri në përgjithësi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME

- ▶ Trajnimi është dizajnuar për realizim në internet në grupe me rreth 10 pjesëmarrës, duke pasur parasysh që një version do të duhet të përpunohet për të mësuar ballë për ballë ose të kombinuar.
- ▶ Trajnimi do të bazohet në seanca sinkronike në internet dhe ose trajnim ballë për ballë dhe punë individuale të ndarë nga pjesëmarrësit në një platformë në internet.
- ▶ Kursi do të ketë 50 orë, përfshirë 24 orë seanca dhe 26 orë punë individuale.
- ▶ Propozimi është për 4 ditë punëtorie dhe 3 faza zbatimi midis secilit trajnim (Detyra shtëpie).

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

	Punëtorja 1	Punëtorja 2	Punëtorja 3	Punëtorja 4
Fushat kryesore	Hyrje, ndërtimi i ekipit, profili i shkollës gjithëpërfshirëse, njohuri themelore rreth fakteve kryesore të gjithëpërfshirjes.	Reflektimi dhe raportimi për sukseset e para. Njohuritë bazë për bullizmin dhe mësimi për të kuptuar dhe përdorur KRRKD-në.	Prezantimi i posterit kundër bullizmit dhe planifikimi i një jave veprimi kundër bullizmit. Njohuritë për faktorët kryesorë për një planifikim të mirë të mësimdhënies gjithëpërfshirëse.	Prezantimi i projektit mjedisor me një analizë të tij të potencialit gjithëpërfshirës dhe demokratik. Seanca të mësimdhënies simuluese nga të gjithë pjesëmarrësit si provë e zhvillimit personal. Informata kthyesë mbi tërë kursin.
Sesioni 1	Hyrje në kurs, formimi i tandemëve për të katër ditët e punëtorisë.	Prezantimi i detyrave të shtëpisë dhe rezultatet e para të zbatimit. Raporti i trajnerit për vizitat në shkolla. Reflektim mbi suksesin dhe vështirësitë e zbatimit.	Prezantimi i posterit kundër bullizmit. Shkëmbimi i përvojës dhe vështirësive.	Përmbledhja e parë e katër ditëve të punëtorisë me një propozim për informata kthyesë të vazhdueshme (tabela). Planifikimi i detajuar i kohës për projektin mjedisor.
Sesioni 2	Tri dimensionet për zhvillimin e shkollës.	Reflektimi personal për 'profilin e vet gjithëpërfshirës' bazuar në lexim.	Planifikimi i përbashkët i javës kundër bullizmit.	4 sesione të mësimdhënies simuluese nga katër ekipe.

Sesioni 3	Diversiteti dhe diferenca në shkollë. Kapitujt 2 - 7 do të shtjellohen në ekupe dhe do të ndahen.	Bullizmi si formë e rëndë e përjashtimit. Mësimdhënësi si bullist. Informata të përgjithshme. Lista kontrolluese kundër bullizmit.	Gjashtë hapa të planifikimit të mësimëve gjithëpërfshirëse. Diskutimi dhe reflektimi mbi pasojat për praktikën e vet mësimore.	Informata kthyesë të ndërsjella për seancat e mësimdhënies simuluese, duke marrë parasysh gjithëpërfshirjen dhe kulturën e demokracisë. Reflektimi i përgjithshëm nga trajneri.
Sesioni 4	Seancë të mësimdhënies simuluese për barazinë. Reflektimi i punëtorisë - dita e parë.	Nga kundër bullizmi deri tek kultura e demokracisë dhe KKK-KD-së. Demokracia dhe cilësia e saj. Modeli KKK (Flutur).	Hyrje në bazat e arsimit mjedisor dhe lidhja e tij me një kulturë të demokracisë në veprim.	Reflektim i përgjithshëm dhe informata kthyesë mbi të tërë kursin në ekupe të vogla dhe sesione plenare. Prezantimi i anketës së vlerësimit që pjesëmarrësit do të marrin në javën vijuese.
Detyre shtëpie	Pjesëmarrësit do të: ► Mësojnë/testojnë 3 ushtrime mësimore ► Ndajnë njohuri të reja me prindër dhe/ose mësimdhënëse. ► Përgatisin një prezantim	Pjesëmarrësit do të: ► Ftojnë një koleg për vëzhgim dhe informata kthyesë. ► Lexoni: Kapitullin 3 për bullizmin dhe hidhni hapat e parë ► Përgatisin një propozim për një poster kundër bullizmit.	Pjesëmarrësit do të: ► Vendosin për një projekt mjedisor ► Ata paraqesin një propozim-dokument të parë ► Përgatisin një nga shembujt e mësimdhënies për mësimdhënien simuluese	Jepni informata kthyesë me shkrim.

PJESA II: PLANET E TRAJNIMIT



PUNËTORIA 1:

HYRJE, NDËRTIMI I EKIPIT DHE PROFILI I SHKOLLËS GJITHËPËRFSHIRËSE

PJESA I – INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Përmbledhje, çështje të adresuara:

Hyrje, ndërtimi i ekipit, profili i shkollës gjithëpërfshirëse, njohuri themelore rreth fakteve kryesore të gjithëpërfshirjes.

PJESA II - SEANCAT HAP PAS HAPI:

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 1 - Seanca 1 - 1.5 orë	Tema: Hyrje Pjesa 1: Akullthyesi, pastaj prezantimi i kursit, për sa i përket kontekstit, procesit, përmbajtjes, qasjes dhe stilit të mësimnxënies, materialeve (manual) dhe rezultateve përfundimtare të pritura. Pjesëmarrësit marrin manualin (version i shtypur) dhe hedhin një vështrim të parë në tabelën e përmbajtjes. Sqarimi i trajnerëve si lehtësues. Njohuritë vijnë kryesisht nga leximi dhe ndarja. Lehtësuesi do të organizojë procesin e mësimnxënies.	Manuale në formatin PowerPoint
	Tema: Formimi i tandemëve të mësimnxënies për tërë kursin Pjesa 2 Hyrje nga lehtësuesi: Mendoni (lexoni) - çiftëzohuni (diskutoni me partnerin mësimor) - ndani do të jetë qasja thelbësore dhe përgatituni për zbatimin e menjëhershëm. Pra: do të punojmë në çifte. Çiftet përzgjidhen përmes kartave që përputhen (shih manualin Pjesa D. 1.1). Ekipet e formuara tani do të kombinohen me një ekip tjetër për të formuar një ekip prej katër vetash. Përmes ushtrimit 'stemë' (D 1.3) ata punojnë në profilin e tyre të kompetencave.	Manual
	Pjesa 3: Reflektimi: Në ekipet e futbollit, ne kemi nevojë dhe pranojmë kompetenca dhe role të ndryshme. Pse kjo është ndryshe në shkollë? Pse zakonisht kërkojmë norma shoqërore dhe nivele të barabarta të njohurive, qasjes së mësimnxënies dhe rezultateve përfundimtare?	

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 1 - Sesioni 2 - 1.5 orë	Tema: Tre dimensionet e zhvillimit për shkollat Pjesa 1: Hyrje dhe detyrë Trekëndëshi i dimensioneve paraqitet shumë shkurtimisht si elemente për zhvillimin e shkollës. Detyra individuale leximi: A/I/1: Tri dimensione (burimet, praktikat, strukturat). Individualisht të gjithë pjesëmarrësit vizatojnë një trekëndësh me tri dimensionet në qoshe dhe përcaktojnë se çfarë duhet bërë ende për të arritur qëllimet e formuluar për secilin dimension! Së bashku me partnerin e tyre të mësimi ata çiftëzohen (diskutojnë) dhe dalin me një vizatim të përbashkët në A3. Kjo paraqitet në seancën plenare (ndajnë).	Manuali i mësimdhënësve A/I/1 Letër A3
	Tema: Prezantimi i trekëndëshave të grupeve. Pjesa 2 Sqarimi: Të tri dimensionet duhet të kuptohen mirë dhe të lidhen me para-njohuritë e të gjithë pjesëmarrësve. Trajnerët duhet të sigurohen që të gjithë pjesëmarrësit të vijnë me këndvështrimin e tyre.	Prezantimet e grupeve
	Tema: Diskutimi dhe përgatitja Pjesa 3 ► Cili është të kuptuarit themelor të dimensioneve? ► Pse janë këto tri dimensione kaq të rëndësishme? ► Poster i përbashkët (tabelë) si qëllim për drejtorin, mësimdhënësit, stafin, prindërit, bordin e shkollës.	

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 1 - Sesioni 3 - 1.5 orë	Tema: Diversiteti dhe diferenca në shkollë 2 - 7 Pjesa 1 Diskutohet pika 1 e kapitullit (tri dimensionet). Pikat 2 - 7 e të kuptuarit themelor tani sqarohen dhe prezantohen. Secili çift merr (rastësisht?) njërin nga kapitujt. Detyra është të paraqitet përmbajtja në një mënyrë (grafike), ashtu që ajo të paraqitet në seancë plenare dhe të gjithë të kuptojnë dhe të mund të diskutojnë rreth saj.	Manuali i mësimdhënësve A/I/ 2 - 7
	Pjesa 2 Prezantimi i 6 elementeve (1.2 - 1.7) nga ekipet.	6 prezantime
	Pjesa 3 Ushtrimi: Secili pjesëmarrës mund të shpjegojë përmendsh shtatë elementet (1.1 - 1.7) sikur ai/ajo po u flet për këtë kolegëve/vizitorëve/prindërve. Pjesëmarrësit e trajnojnë njëri-tjetrin në ekipe me mbështetjen e manualit.	Manuali i mësimdhënësve
	Pjesa 4 Reflektimi: ► Çfarë mësova sot (3 pikë secila në letër ngjitesë)? Mbledhur dhe grupuar në një mur në seancë plenare. ► Çfarë dija disi, por nuk e shpreha kurrë?	Postoje. Mur për të shfaqur shënimet.

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 1 - Sesioni 4 - 1.5 orë	Tema: Ne jemi të gjithë të barabartë, por disa janë më të barabartë se të tjerët. Pjesa 1 Hyrje: Së bashku bëhet një aktivitet arsimor (mësimdhënie simuluese) dhe reflektohet. Nga kapitulli i perceptimit të të tjerëve (D/1.4) pyetjet në lidhje me mundësitë e (pa)barabarta. Salla është e organizuar në mënyrë që ushtrimi të mund të zhvillohet dhe të realizohet nga trajneri (ose një pjesëmarrës i përgatitur).	Manuali i mësimdhënësve D/1.4/4
	Pjesa 2 Informata kthyesë: ► Si u zhvillua mësimi? ► Çfarë mësova për gjithëpërfshirjen? ► Cili nga elementët nga sesioni i kaluar është prekur?	
	Pjesa 3 Zbatimi: ► Si mund ta bëja atë në klasën time? ► Si mund ta përshtat atë me moshën? ► Si do të sigurohem që TË GJITHË mund të marrin pjesë?	
	Pjesa 4 Reflektimi i ditës: Cila është diferenca midis gruas/burrit që hyn dhe del nga kjo punëtori?	Postoje Tabelë (flipchart)

Koha	Përshkrimi
Detyrë shtëpie	Tema: Detyra shtëpie deri në punëtorinë tjetër Pjesëmarrësit do të: ► Mësojnë/testojnë 3 ushtrime mësimore nga manuali. ► Ndajnë elementët kryesorë nga 'Çfarë është mirë të dihet' (1 - 7) me një grup prindërisht dhe/ose mësuesish që nuk janë të përfshirë në trajnim. ► Përgatisin së bashku me partnerin e ekipit tuaj një prezantim (maks. 5') për rezultatet e të dy detyrave.

PUNËTORIA 2:

REFLEKTIMI I ROLIT TË MËSIMDHËNËSIT NË GJITHËPËRFSHIRJE DHE TEMA E BULLIZMIT

PJESA I – INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Përmbledhje, çështje të adresuara:	Reflektimi dhe raportimi për sukseset e para. Njohuritë bazë për bullizmin dhe mësimi për të kuptuar dhe përdorur KRKKD-në.
------------------------------------	---

PJESA II - SEANCAT HAP PAS HAPI:

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 2 - Sesioni 1 - 1.5 orë	Tema: Prezantimi i detyrës së shtëpisë Pjesa 1 Akullthyesi. Pastaj, trajneri vendos në cilën mënyrë do të paraqitet detyra e shtëpisë: Do të ishte e mërzitshme të bëheshin thjesht njëra pas tjetrës. Prezantimi dhe ekspozita e posterit? Ekipet më të vogla në të cilat po prezantohen dhe diskutohen rezultatet?	Manual i akullthyesit.
	Tema: Rezultatet e zbatimit të parë Pjesa 2 Në seancë plenare do të ketë një diskutim (rrethi i karrigeve) mbi vështirësitë dhe sukseset. Fillon me raportimin e trajnerit për vizitat e tij/saj në klasë, do të tregojë fotografi nëse është e mundur dhe rezultatet e diskutimit-informatave kthyesë me mësimdhënësin e vizituar (të cilin e reflektojmë në rezultatin e vizitës së trajnerit).	Raporti mbi vizitat në klasë nga trajneri i mbështetur me fotografi (ppt).
	Tema: Reflektimi personal Pjesa 3 Diskutim i hapur për të finalizuar retrospektivën në ditën e parë të punëtorisë dhe detyrën e shtëpisë: ► Në cilën mënyrë u ngrit ndërgjegjësimi im në lidhje me temën e gjithëpërfshirjes? ► Çfarë mund të zbatoja? ► Çfarë nuk funksionoi? Pse? ► Sa mirë mund të integroja njohuritë e reja në mësimdhënien time? ► Si e shoh zhvillimin profesional personal dhe profilin e shkollës sime? ► Sa i sigurtë mund të jem në lidhje me atë? Informacion nga trajneri: Reflektimi personal dhe njohuritë do të jenë përmbajtja e seancës vijuese.	Tabela për të mbledhur pikat e diskutimit.

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 2 - Sesioni 2 - 1.5 orë	Tema: Çfarë është mirë të reflektohet? Pjesa 1 Hyrje: Mësimdhënësi si praktikues reflektues. Trajneri prezanton këtë qasje dhe hap një rund të parë të 'blitz': Secili pjesëmarrës e përfundon fjalinë e mëposhtme: "Reflektimi si mësimdhënës dhe si person do të thotë që unë rregullisht". Detyra: Pjesëmarrësit punojnë në 5 ekipe duke ndjekur 5 kapitujt e A/II: Çfarë është mirë të reflektohet. Titujt e 5 kapitujve janë shkruar në copa letre, ekipet zgjedhin rastësisht një. Të 5 ekipet e lexojnë kapitullin dhe më pas u përgjigjen pyetjeve të reflektimit në një ppt.	Manuali i mësimdhënësve
	Tema: të mësuarit nga njëri-tjetri Pjesa 2 Përpilohen të 5 prezantimet në PowerPoint dhe një prezantim në seancë plenare do t'u ndihmojë të 5 ekipeve të fitojnë njohuri për të 5 kapitujt. Trajneri sigurohet që asnjë informacion të mos humbasë dhe i shtohet asaj nëse është e nevojshme.	Prezantimi në ppt përgatitet nga ekipet
	Tema: Reflektimi Pjesa 3 Në fillim, trajneri përmbledh ato që ka dëgjuar dhe jep një koment dashamirës dhe çmues. Ai/ajo tregon elementet që i ka humbur dhe i fton pjesëmarrësit të formulojnë mendimet e tyre. Çfarë vështirëse mund të pranoj? Cilat forma të diferencës janë të vështira për mua t'i toleroj? Si ka ndryshuar kjo për mua dhe/ose për shoqërinë/vendin tonë gjatë viteve të fundit? A po bëhet më mirë apo më keq?	Rrethi i karrigeve.

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 2 - Sesioni 3 - 1.5 orë	Tema: Bullizmi: Një formë e rëndë e përjashtimit të përditshëm. Pjesa 1: Hyrje nga trajneri për rezultatet e PISA-s mbi bullizmin në të gjithë botën dhe në Kosovë- Detyra: "Në një fletë A4 ju shkruani mirë dhe lexueshëm përkufizimin tuaj për bullizmin." Pa diskutim të mëtejshëm, secili përkufizim lexohet në seancë plenare dhe varet në mur (ulur në një rreth)? Rund i shkurtër diskutimi: ► Cila është përvoja juaj personale me bullizmin? ► A ju kujtohet të keni qenë viktimë të bullizmit? ► Pse është kaq e vështirë të rrëfesh apo edhe të kujtoesh se ke qenë viktimë e bullizmit? A është kjo për shkak se është e vështirë të jesh viktimë (e dobët)? ► Pse është kaq e vështirë për mësimdhënësit të vetëdijesohen për bullizmin në klasë? ► Dhe çfarë kur mësimdhënësi është bullist?	https://www.osce.org/kosovo/120706 https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/cd52fb72-en.pdf?expires=1622208856&id=id&accname=guest&checksum=-6C3AB6E2024D-F67563E0D-5C018D4D464
	Tema: Vetëdijesimi për problemin dhe diskutimi i zgjidhjeve Pjesa 2 Detyra: "Lexoni artikullin rreth mësimdhënësve bullist në manualin dhe ndani përshtypjet tuaja në grupe me nga 4 (dy çifte punuese)." Pyetjet/temat që do të trajtohen (që do të mblidhen në një tabelë): ► Cilat janë efektet e mësimdhënësve bullist tek nxënësit? ► Pse nuk diskutohet realisht për këtë FAKT në shkollë? ► Si mund të luftoni kundër rrezikut për të mos u bërë bullist? Eja-ni me një listë kontrolli me të paktën 10 pika në pjesën e pasme të së njëjtës tabelë. ► Ndani këndvështrimin tuaj personal dhe mblidhni rezultatet në grupin në tabelë.	Manuali i mësimdhënësve Letra tabelash (flip-chart)
	Tema: Informata të përgjithshme Pjesa 3 Posterat shfaqen pa diskutim në mur. Pastaj: detyrë individuale leximi: "Lexoni kapitullin "Informata të përgjithshme për temën e bullizmit për edukatorët. Në mur gjeni tabelën me titullin e nën-kapitujve 2 a) - h). Për secilin nga 8 nën-kapitujt, përdorni të paktën 3 shënime në fleta të vogla (ang.: post-it notes) për të shkruar fjalët kyçe që janë të rëndësishme për mësimdhënësit dhe prindërit si informata të përgjithshme mbi bullizmin." Kur të keni mbaruar, grupi fillestar i katër personave nga detyra e fundit merr përsëri listën e tyre të kontrollit të bullizmit dhe tani shtoni, korrigjoni, plotësoni dhe ndryshoni atë në një listë që ka titullin: "Çfarë duhet të dinë të gjithë për bullizmin në shkollën tonë!"	Postoje.

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 2 - Sesioni 4 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Nuk ka hapësirë për bullizëm - Kultura e demokracisë. Duke treguar 'Fluturën' dhe duke dhënë një prezantim të shkurtër të historisë së KRKKD-së që çon në temën 'Demokracitë sot' duke iu referuar disa zhvillimeve kritike të fundit në disa demokraci duke iu referuar raportit të vitit 2021 të Freedom House: "Ne duhet t'i përgjigjemi pyetjes kryesore: Cila është cilësia e një demokracie? Cila është kultura e demokracisë? Pse bullizmi në një institucion demokratik si një shkollë publike është skandal? Kjo është arsyeja përse ne do të hedhim një vështrim në pritjet tona."	https://freedomhouse.org/sites/default/files/2021-02/FIW2021_World_02252021_FINAL-web-upload.pdf
	Pjesa 2 Tema: Cila është cilësia e një demokracie? Diskutime në ekipe të vogla: ► Çka pres nga një shtet demokratik? Cilat do të ishin standardet minimale për një shoqëri që e quan veten 'demokratike'? Cila është përvoja ime personale? Fjalët kyçe po mbledhen në një mur. ► Trajneri aranzhon fjalët kyçe sipas 'demokracisë si formë e sundimit' dhe 'demokracisë si mënyrë jetese'. Kjo çon në temën e kulturës së demokracisë. ► Përsëri një referencë në raportin e Freedom House dhe faktorët që ata përdorin. Më pas hedhim një vështrim në 'nivelet' e ndryshme të demokracisë dhe kërkojmë të reflektojmë mbi përvojën individuale të demokracisë në rritje ose zvogëlim.	
	Pjesa 3 Tema: Modeli KKD Prezantimi i shkurtër i modelit KKD, i kontekstit dhe procesit të zhvillimit të tij, dhe strukturës së tij. 20 kompetencat duhet të kuptohen për detyrën vijuese të grupeve: Secili grup identifikon një situatë në lidhje me një situatë bullizmi në shkollë (një konflikt, një polemikë, një situatë sfiduese), nga përvoja e vetë pjesëmarrësve, nga media masive ose media sociale. ► Grupi do të analizojë situatën me "Ilupat KKD", duke identifikuar: ► Kompetencat për kulturën demokratike që u përdorën nga pjesëmarrësit në situatë. ► Kompetencat për kulturën demokratike që mund të ishin të dobishme që situata të evoluonte në një mënyrë pozitive. Secili grup duhet të sigurojë argumente dhe shpjegime, bazuar në analizën e përkufizimeve të kompetencave të përzgjedhura.	Flutura KKD në një version më të madh (vizatim dore nga trajneri?)
	Pjesa 4 Prezantime Grupet paraqesin shembujt dhe gjetjet e tyre. Pjesëmarrësit ndajnë përshtypjet e tyre të para për KKD-në.	

Koha	Përshkrimi
Detyrë shtëpie	Tema: Detyra shtëpie deri në punëtorinë tjetër Pjesëmarrësit do të: ▶ Mësojnë/testojnë 3 ushtrime mësimore nga manuali: Ftojnë një koleg për vëzhgim dhe informata kthyese. ▶ Lexoni: Kapitulli 3 mbi Bullizmin - Ndërmarrja e veprimeve mbi temën e Bullizmit (parandalimi dhe ndërhyrja): Hidhni një hap të parë në parandalimin dhe jini gati për raportim në punëtorinë e ardhshme. ▶ Përgatitni një propozim për një poster kundër bullizmit për shkollën në bashkëpunim me disa nxënës dhe kolegë (informacion në lidhje me ekspozitën në punëtorinë tjetër).

PUNËTORIA 3:

BULLIZMI DHE GJITHËPËRFSHIRJA NË PRAKTIKË

PJESA I – INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Përmbledhje, çështje të adresuara:	Prezantimi i posterit kundër bullizmit dhe planifikimi i një jave veprimi kundër bullizmit. Njohuritë për faktorët kryesorë për një planifikim të mirë të mësimeve gjithëpërfshirëse.
------------------------------------	---

PJESA II - SEANCAT HAP PAS HAPI:

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 3 - Sesioni 1 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Prezantimi detyrës së shtëpisë: Ekspozita e posterit Ekspozitë e posterëve kundër bullizmit dhe konkurs i brendshëm. Secili pjesëmarrës ka 5 pika vetë-ngjitëse që ai/ajo mund të caktojë lirisht. Kriteret: Projektimi grafik dhe kuptueshmëria.	Posterat e pjesëmarrësve
	Pjesa 2 Tema: Përvoja e veprimit Në seancë plenare, një nga trajnerët raporton për një vizitë në shkollë në shkollën e një prej pjesëmarrësve. Diskutime dhe shkëmbime në 4 rrethe karrigesh: Dy runde: 1. Secili pjesëmarrës raporton në njërin nga ushtrimet mësimore të testuara. 2. Secili pjesëmarrës raporton për njërin nga veprimet parandaluese të bullizmit që ai/ajo ka ndërmarrë.	Raporti i trajnerit për vizitat (ppt).

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 3 - Sesioni 2 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Planifikimi i një jave kundër bullizmit në shkollë Me sfondin e njohurive në lidhje me bullizmin dhe propozimet e parandalimit/ndërhyrjes, pjesëmarrësit zhvillojnë një plan veprimi për një javë realiste kundër bullizmit. Si mbështetje, ata mund të përdorin tabelën e planifikimit për ditën e pastrimit (shih manualin).	Manuale Tabelë (flipchart) Prezantimi i Power-Point-it
	Pjesa 2 Tema: Prezantimi dhe informatat kthyes reciproke. Ekipet paraqesin planet e tyre (tabelë (flipchart) ose PowerPoint). Pas çdo prezantimi pjesëmarrësit japin informata kthyes dhe propozime për përmirësim.	Ppt nga pjesëmarrësit

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 3 - Sesioni 3 - 1.5 orë	Pjesa 1 Planifikimi i mësimdhënies gjithëpërfshirëse Prezantimi i Pjesës III: Si të planifikoni mirë - Gjashtë hapat drejt planifikimit të mësimëve gjithëpërfshirëse.	Prezantimi i ppt-së nga trajneri bazuar në manual.
	Pjesa 2 Diskutimet për përgatitjen e mësimdhënësve për planifikimin e mësimëve Në çifte, pjesëmarrësit vendosin për dy nga 6 hapat për të analizuar dhe diskutuar (trajnerët sigurohen që të gjashtë hapat të përzgjidhen të paktën një herë). Përgatitja e një prezantimi në tabelë. ▶ Si e ndryshon përgatitjen time mësimore nëse e marr parasysh këtë hap? ▶ Çfarë duhet të di/mësoj akoma për të zbatuar këtë hap? ▶ Çfarë mbështetjeje më duhet nga menaxhmenti i shkollës? ▶ Çfarë mbështetjeje më duhet nga trajneri i projektit?	Manuali i mësimdhënësve tabelë
	Pjesa 3 Tema: Prezantimi i analizave të grupeve Paraqiten analizat e gjashtë hapave. Kur d.m.th. hapi 1 paraqitet nga një ekip dhe të tjerët kanë përgatitur të njëjtën gjë, ata plotësojnë elementet që mungojnë ose diferencat e analizave të tyre.	Prezantime nga pjesëmarrësit në tabelë.
	Pjesa 4 Tema: Reflektimi dhe diskutimi i pasojave. Rregullimet në rutinat e veta profesionale marrin kohë. Mësimdhënësit duhet të kenë mundësinë të formulojnë dhe të ndajnë dyshimet, frikat dhe shpresat e tyre. Trajneri gjen formën e duhur për ta bërë këtë. Kjo mund të bëhet në seancë plenare, përmes shënimeve individuale, përmes formave joverbale (vizatime, objekte etj.).	

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 3 - Sesioni 4 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Edukimi mjedisor - themelor dhe i rëndësishëm. Në hapin e parë, mësimmshënësist sqarojnë qëndrimet mbi edukimin mjedisor. Trajneri fillon me një element tërheqës motivues. Për shembull, me një vështrim të përbashkët në koshin e plehrave në shkollë dhe një diskutim vijues rreth realitetit të jetës së sotme, por pa sjellë komponentë morale negative në diskutim. Detyrë leximi: Hyrje në kapitullin e edukimit mjedisor: 'Edukimi mjedisor me një histori të gjatë'. Pyetjet për t'u zgjidhur: ▶ Sa e rëndësishme ishte kjo kur isha i ri? ▶ Sa e shohin brezat e ndryshëm këtë? ▶ Si jam përgatitur si mësimmshënës për kauzën? ▶ Pse është bërë më e rëndësishme? ▶ Si është e lidhur me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm 2030 të OKB-së? Pjesëmarrësit marrin shënime personale (mendojnë) pasi t'i lexojnë dhe diskutojnë këto (ndajnë) me partnerin e tyre të punës. Cilat janë diferencat dhe pikëpamjet e përbashkëta?	Grumbullimi i mbeturinave. Fotografite e mbeturinave në publik etj.
	Pjesa 2 Tema: Mjedisi si pjesë e një mjedisi demokratik. Në seancë plenare, trajneri mbështet tani një diskutim që përqendrohet në pyetjen, në të cilën mënyrë edukimi mjedisor mund të jetë pjesë e kulturës së demokracisë. Me ndihmën e 'fluturës' dhe 135 përshkruesve dhe duke përdorur posterin e kopshtit, një profil i dy projekteve të propozuara zhvillohet në ekipe më të vogla.	Flutura. Manuali i mësimmshënësve
	Pjesa 3 Tema: Profili i demokracisë së projekteve mjedisore. Në dy ekipe, pjesëmarrësit tani zhvillojnë profilet e dy propozimeve (kopshtimi shkollor dhe dita e pastrimit). Duke përdorur posterin e kopshtit, ky do të jetë gjithashtu një ushtrim argëtues. Prezantimi i posterave do të tregojë potencialin demokratik dhe didaktik të kësaj pune.	Kopjet e posterit të kopshtit. Manuali i mësimmshënësve
	Pjesa 4 Tema: Prezantimi i mësimmshënies simuluese gjatë punëtorisë së ardhshme Gjatë punëtorisë së fundit, pjesëmarrësit do të paraqesin në 4 ekipe të vogla nga një klasë secili dhe me pjesëmarrësit e tjerë në formë të mësimmshënies simuluese. Pjesëmarrësit duhet ta kuptojnë mirë detyrën, kështu që ata përgatisin materialet dhe planifikimin e detajuar.	

Koha	Përshkrimi
Detyrë shtëpie	Tema: Detyra shtëpie deri në punëtorinë tjetër Pjesëmarrësit do të: - Diskutojnë në shkollën(at) e tyre, cilin projekt mjedisor ata do të planifikojnë dhe realizojnë në kohën e duhur. - Ata do të paraqesin një propozim të parë për secilin në seancë plenare në fillim të punëtorisë në vijim. - Ata mund të vendosin për njërin nga projektet e propozuara (kopshtari ose dita e pastrimit) ose të zgjedhin diçka, që përputhet më shumë me shkollën e tyre dhe me dëshirat dhe nevojat e tyre. - Trajneri mund të vendosë që të ketë dy propozime projektesh për shkollë, në mënyrë që të ketë një larmi idesh për t'u diskutuar. - Përgatisin një nga shembujt e mësimdhënies nga manuali (Ushtrime dhe plane mësimore për lajmet ditore) në ekipe të vogla.

PUNËTORIA 4:

PRAKTIKA E MËSIMDHËNIES E DUKSHME PËRMES MËSIMDHËNIES SIMULUESE

PJESA I – INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Përmbledhje, çështje të adresuara:	Prezantimi i projektit mjedisor me një analizë të tij të potencialit gjithëpërfshirës dhe demokratik. Seanca të mësimdhënies simuluese nga të gjithë pjesëmarrësit si provë e zhvillimit personal. Informata kthyese mbi tërë kursin.
---	--

PJESA II - SEANCAT HAP PAS HAPI:

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 4 - Sesioni 1 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Përmbledhje dhe fillimi i reflektimit të kursit. Pas një akullthyesi, trajneri fillon me raporte për vizitat e tij/saj në shkollë dhe për vëzhgimet dhe rezultatet. Një përmbledhje e ditës gjithashtu përfshin faktin, se kjo do të jetë dita e fundit e trajnimit zyrtar. Trajneri vendos një tabelë lart në mur dhe mbështet pjesëmarrësit për ta mbushur atë gjatë ditës me shënime: çfarë mësova? Çfarë kam zbatuar? Çfarë do të më duhet në të ardhmen?	Kuti mjetesh për akullthyesin për trajnerë.
	Pjesa 2 Tema: Idetë tona për projekt mjedisor. Idetë e përgatitura për projekt prezantohen dhe diskutohen në seancë plenare. ► Sa gjithëpërfshirës është propozimi? ► Cili problem mjedisor do të zgjidhet ose përqaset? ► Në cilën mënyrë zbatohet ose konsiderohet KRKKD-ja?	
	Pjesa 3: Tema: Planifikimi i detajeve. Ajo që është e nevojshme do të jetë një orar dhe tabelë detyrash. Në seancat plenare (nëse vetëm një projekt) ose në ekiye të vogla, pjesëmarrësit tani ndërmarrin hapa realë për planifikim.	Tabelë për planifikim të detajuar

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 4 - Sesioni 2 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Mësimdhënie simuluese 1 Pjesëmarrësit e ekipit 1 e realizojnë mësimin e tyre të mësimdhënies simuluese në një hapësirë kohore 20-minutëshe. Të tjerët janë 'nxënësit e tyre simulues'.	Materialet e përgatitura për mësimin e zgjedhur
	Pjesa 2 Tema: Mësimdhënie simuluese 2	Materialet e përgatitura për mësimin e zgjedhur
	Pjesa 3 Tema: Mësimdhënie simuluese 3	Materialet e përgatitura për mësimin e zgjedhur
	Pjesa 2 Tema: Mësimdhënie simuluese 4	Materialet e përgatitura për mësimin e zgjedhur

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 4 - Sesioni 3 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Reflektimi dhe informata kthyesë të seancave të mësimdhënies simuluese 15 minuta janë të rezervuara për informata kthyesë dhe të rëndësishme për seancat e mësimdhënies simuluese: ▶ Në cilën mënyrë ishte gjithëpërfshirëse (duke përdorur kriteret e manualeve)? ▶ Si zbatohet KRKKD-ja (duke përdorur formularin përkatës nga manuali). ▶ Cila është cilësia e mësimdhënies dhe përfshirja e të gjithë nxënësve? Sa mirë është e ndarë koha midis mësimdhënies dhe mësimnxënies? ▶ Sa interesante dhe argëtuese ishte për ne?	
	Pjesa 2 Tema: Reflektimi dhe përshtypjet nga trajneri. Trajneri së pari komenton mbi cilësinë e informatave kthyesë dhe më pas jep një përmbledhje të mësimave të ndjekura dhe sesioneve të mësimdhënies simuluese të vëzhguar: Çfarë është zhvilluar? Çfarë mësuan pjesëmarrësit?	

Koha	Përshkrimi	Burimet
Punëtorja 4 - Sesioni 4 - 1.5 orë	Pjesa 1 Tema: Shqyrtimi i 4 ditëve të punëtorisë dhe i detyrave të shtëpisë. Hyrje: Trajneri kujton qëllimet, proceset në lidhje me detyrën, aktivitetet e zbatimit dhe përdor posterin me shënimet e pjesëmarrësve të prezantuar në fillim të kësaj dite të punëtorisë.	Posteri nga seanca ditore një
	Pjesa 2 Tema: Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 4 (dy ekipe mësimore): Prezantohen dhe komentojnë njëri-tjetrin ▶ Elementet më të rëndësishme të përfshirjes dhe demokracisë të integruara në aktivitetin tuaj të zbatimit ▶ Hapat tuaj konkretë të ardhshëm ▶ Disa sfida të mundshme për t'u zgjidhur ▶ Si e shihni ndikimin tuaj në situatën e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve që jetojnë në Kosovë?	
	Pjesa 3 Seancë plenare: prezantimi i rezultateve të grupeve Konkludimi i seminarit Trajneri inkurajon pjesëmarrësit që të ▶ përdorin burime ▶ qëndrojnë në kontakt me njëri-tjetrin ▶ përgjigjen anketës së vlerësimit	
	Informimi/informata kthyesë Anketa e vlerësimit që do të dërgohet pas përfundimit të kursit	

PJESA III: KUTIA E MJETEVE E TRAJNERËVE



SI TË MBËSHTET ZBATIMI I PËRFSHIRJES NË MËSIMDHËNIEN E PËRDITSHME?

BAZAT PËR PRAKTIKËN E MËSIMDHËNIES SË PËRDITSHME

Konceptet e sallës

Tavolinat dhe stolat u rreshtuan dhe një dërrasë e zezë në krye të klasës. Koncepti hapësinor tradicional i shkollës dhe metoda shoqëruese e mësimdhënies frontale ka pasur ditën e vet. Sidomos kur fëmijët me aftësi dhe nevoja të ndryshme mbështetëse mësohen së bashku në një klasë. Këtu, nevojiten koncepte të reja, të ndryshueshme të sallës, të cilat gjithmonë mund të përshtaten me nevojat aktuale. Ne do të dëshironim t'ju tregojmë këtu se si mund të krijoni një mjedis optimal të mësimnxënies dhe ndonjëherë të arrini gjëra të mëdha me masa të vogla. Disa jastëkë në dysheme ose një tavolinë me stola rreth saj - vendi për rrethin e mëngjesit është gati!

Rrethi i mëngjesit është një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë për t'u dhënë fëmijëve fillimin më të mirë të mundshëm të ditës së tyre në shkollë. Kur ulen së bashku në një rreth, fëmijët dhe mësimdhënësit takohen në nivelin e syve. Kjo promovon kohezionin e klasës dhe ofron një mundësi për një shkëmbim të qetë idesh, ku gjithçka mund të diskutohet, nga udhëtimi i ardhshëm në klasë te projektet e planifikuara deri te konfliktet e mundshme që aktualisht janë në mendjet e fëmijëve.

Mësimdhënësit mund të organizojnë një shumëllojshmëri të gjerë të qasjeve pedagogjike që janë të përshtatshme për zhvillimin e KKD-së dhe kështu të ndihmojnë në krijimin e mjediseve më të këndshme dhe të sigurta të mësimnxënies ndërsa adresojnë strukturat e dhunshme, diskriminuese dhe anti-demokratike brenda mjediseve të klasës. Trajneri duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë, duke ditur gjithashtu se këto sugjerime gjithmonë mbivendosen me qasjet për mësimdhënie dhe mësimnxënie të mirë në përgjithësi.

Përmes planifikimit, ndjekjes së zhvillimit të KKD-së midis nxënësve dhe vlerësimit të aktiviteteve të tyre, mësimdhënësit si lehtësues të mësimin do të përqendrohen në parimet e Kornizës dhe të miratojnë qasje dhe metoda pedagogjike që inkurajojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në përvojën, zbulimin, sfidën, analizën, krahasimin, reflektimin dhe bashkëpunimin. Ata rishikojnë rolin e tyre në klasë për të adresuar më mirë nxënësit si persona të tërë dhe për të angazhuar fëmijët me kokën, zemrën dhe duart e tyre dhe të zhvillojnë praktika që janë më të përshtatshme për zhvillimin e autonomisë dhe përgjegjësisë së nxënësve në çështjet e kompetencës për një kulturë demokratike.

Për t'iu përgjigjur një pyetjeje të dëgjuar shpesh, pjesëmarrësit tuaj mund të kenë që në fillim: Zhvillimi i KKD-së mund të kuptohet në mënyrë të qartë, si temë dhe në mënyrë të nënkuptuar, si shqetësim transversal i integruar në proceset e përgjithshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies që ndodhin në shkollë brenda një kornize të përgjegjësisë së përbashkët. Qasjet pedagogjike të integruara në KKD dhe të përshkruara më poshtë janë, siç do ta dinë edukatorët me përvojë, jo vetëm të përshtatshme për zhvillimin e KKD-së, por ato gjithashtu ndihmojnë në krijimin e mjediseve më të këndshme dhe të sigurta të mësimnxënies dhe gjetjen e mënyrave për të adresuar struktura të dhunshme, diskriminuese dhe anti-demokratike brenda mjediseve shkollore.

SI TË ORGANIZOHET PROCESI I MËSIMNXËNIES

Pyetjet e mëposhtme mund të drejtojnë reflektimin se si të organizohen proceset mësimore.

Deri në çfarë mase do të thonit që mësimdhënia juaj kontribuon që nxënësit të bëhen qytetarë aktivë/duke respektuar të drejtat e njeriut?
Sa shpesh nxënësit tuaj kanë mundësi të shprehin idetë e tyre/të dëgjojnë pikëpamje të ndryshme, të diskutojnë ndryshimet e tyre në klasë?
Sa shpesh shtrohen pyetjet në lidhje me të drejtat e njeriut, qytetarinë demokratike, drejtësinë, barazinë ose sundimin e ligjit në klasat që ju jepni mësim?
Si po e lehtëson praktika juaj e tanishme zhvillimin e burimeve intelektuale, personale dhe shoqërore që do t'iu mundësojë nxënësve të marrin pjesë si qytetarë aktivë?
Si po u siguron kohë nxënësve të punojnë me njëri-tjetrin për të forcuar të kuptuarit e tyre, si dhe të praktikojnë shkathtësitë shoqërore, duke nxitur kështu si proceset individuale ashtu edhe ato shoqërore dhe rezultatet përfundimtare?
Sa shpesh jeni duke përfshirë aktivitete praktike dhe qasje eksperimentale?
A e praktikoni në mënyrë efektive përvojën e mëparshme të nxënësve në mësimdhënien tuaj?

PARIMET E PLANIFIKIMIT

Planifikimi dhe ndjekja e zhvillimit të KKD-së midis nxënësve është i rëndësishëm për të gjithë lehtësuesit e mësimnxënies. Të qenit i vetëdijshëm për disa do të ndihmojë mësimdhënësit, si lehtësues të përfshijnë mundësi për:

Përvoja. Një mënyrë e përshtatshme për zhvillimin e qëndrimeve të respektit dhe hapjes, si dhe ndjeshmërisë, është duke siguruar mundësi për të mësuar përmes përvojës, të cilat mund të jenë reale ose të imagjinuara; nxënësit janë në gjendje t'i përjetojnë këto qëndrime përmes, për shembull, lojërave, aktiviteteve, mediave tradicionale dhe mediave sociale, ndërveprimit ballë për ballë me të tjerët ose përmes korrespondencës.

Krahasimi. Nxënësit mund të përfitojnë nga ekspozimi ndaj "diferencës". Nxënësit shpesh krahasojnë atë që është e panjohur me atë që është e njohur dhe e vlerësojnë të panjohurën si "të çuditshme", si "më keq" apo edhe si "të paqytetëruar". Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë lloj krahasimi të vlerës dhe ta zëvendësojnë atë me krahasimin për të kuptuarit, që përfshin shikimin e ngjashmërive dhe diferencave në një mënyrë jo-gjyquese dhe marrjen e perspektivës së tjetrit. Nxënësit reflektojnë dhe angazhohen në një krahasim të vetëdijshëm të vlerave dhe qëndrimeve të tyre me ato të ndryshme, në mënyrë që të vetëdijesohen se si e ndërtojnë ata realitetin.

Analizimi. Pas ngjashmërive dhe diferencave ka shpjegime për praktika, mendime, vlera dhe besime. Lehtësuesit mund të mbështesin nxënësit e tyre në analizën e asaj që mund të qëndrojë nën atë që ata mund të shohin të tjerët duke bërë dhe thënë. Kjo mund të arrihet, për shembull, me diskutim dhe analizë të kujdesshme, përmes metodave të bazuara në kërkime, të burimeve të shkruara ose audio/video.

Reflektimi. Krahasimi, analizimi dhe përvoja duhet të shoqërohen nga koha dhe hapësira për reflektim dhe zhvillim të vetëdijesimit dhe të kuptuarit kritik. Lehtësuesit, veçanërisht në arsimin joformal dhe formal, duhet të sigurojnë që koha dhe hapësira e tillë të sigurohet në një mënyrë të qëllimshme dhe të planifikuar.

Veprimi. Reflektimi mund dhe duhet të jetë baza për ndërmarrjen e veprimeve, për angazhimin me të tjerët përmes dialogut dhe për t'u përfshirë në aktivitete bashkëpunuese me të tjerët. Lehtësuesit mund të marrin përgjegjësinë e inkurajimit dhe madje edhe të menaxhimit të veprimeve bashkëpunuese, për shembull në bërjen e përmirësimeve në mjedisin social dhe fizik përmes qasjeve që përfshijnë "tërë shkollën" ose partneriteteve shkollore.

METODAT/QASJET

Nëse mësimdhënësit vendosin të zbatojnë KKD-në në mësimdhënien e tyre, tetë metoda/qasja (varet nga tradita pedagogjike profesionale se si përdoren termit në vende të ndryshme) ndihmojnë për të ndërmarrë veprime. Pesë metodat e para përqendrohen në vetë procesin e mësimnxënies, të trijat që pasojnë lidhen më shumë me përmbajtjen specifike.

a) Metodatat dhe qasjet e orientuara drejt procesit

- ▶ Modelimi i qëndrimeve dhe sjelljeve demokratike
- ▶ Proceset demokratike në klasë
- ▶ Mësimnxënia bashkëpunuese
- ▶ Mësimnxënia e bazuar në projekt
- ▶ Mësimnxënia e bazuar në shërbim

b) Metodatat dhe qasjet e bazuara në përmbajtje

- ▶ Përdorimi i kurrikulës ekzistuese - brenda fushave lëndore
- ▶ Mësimdhënia ekipore dhe qasjet kurrikulare të integruara
- ▶ Adresimi i "kurrikulës së fshehur".

Modelimi i qëndrimeve dhe sjelljeve demokratike

Mënyra se si mësimdhënësit komunikojnë dhe ndërveprojnë me nxënësit ka një ndikim të madh në vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë e fituara nga nxënësit. Vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë demokratike nuk mund të përvetësohen përmes mësimdhënies zyrtare vetëm për demokracinë, por duhet të praktikohen. Vlerat transmetohen në mënyrë implicite përmes mënyrës së veprimit dhe komunikimit të mësimdhënësve. Edukatorët mund të zhvillojnë më shumë vetëdijesimin për vlerat që ata përçojnë dhe pasqyrojnë në praktikën e tyre të përditshme, vlerat, qëndrimet, shkathtësitë dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik që duhet të zhvillojë. Zgjedhjet e bëra nga edukatorët mund të mbështesin - ose të pengojnë - zhvillimin e një karakteri demokratik me nxënësit. Qasjet e mësimnxënies në veprim dhe mësimnxënia me përvoja i angazhojnë nxënësit në një proces të përvojës, sfidës dhe reflektimit që ka një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e KKD-së. Përmes qëndrimeve, sjelljeve dhe praktikave të tyre mësimdhënësit mund të krijojnë mjedise të sigurt të mësimnxënies, të adresojnë diskriminimin dhe të mbështesin mësimin e individualizuar të një baze të gjerë ose të përbërësve themelorë njerëzorë.

Mësimdhënësit mund të reflektojnë se si vlerat në modelin KKD mbështeten në praktikën e tyre. Për shembull, mësimdhënësi që zgjedh të hetojë se si vlera e tij ose e saj e "drejtësisë" luan në aktivitetet e përditshme me nxënësit, mund të provojë një praktikë të re bazuar në këtë vlerë, ta pilotojë atë dhe të reflektojë në të.

Mjediset e mësimnxënies kanë një ndikim në angazhimin dhe mësimnxënien e nxënësve. Është e rëndësishme të nxisni hapësira të hapura të sigurt për mësimnxënie gjithëpërfshirëse dhe efektive dhe për menaxhimin e dialogëve të vështira ose shkëmbimeve emocionale ku nxënësit ndihen të sigurt për të shprehur mendimet dhe mosmarrëveshjet e tyre. Kur mësimdhënësit përqafojnë metodat gjithëpërfshirëse, ata u dërgojnë një mesazh kuptimplotë nxënësve: ata thonë "ju të gjithë jeni të rëndësishëm dhe të vlefshëm", "të gjithë mund të mësojmë nga njëri-tjetri". Kjo është veçanërisht kritike në klasa të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, ku kërkohen qasje pedagogjike që vlerësojnë përkatësitë specifike kulturore të nxënësve.

Kur përfshijnë në praktikën e tyre të përditshme modelimin e qëndrimeve dhe sjelljeve demokratike, mësimdhënësit do të vendosin vlerat e KKD-së. Ata me vetëdije do të zhvillojnë vetëdijesimin për vlerat e tyre, duke harmonizuar praktikën dhe vlerat dhe do të mbështesin zhvillimin e grupeve të mëposhtme të kompetencave:

- Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut
- Vlerësimi i diversitetit kulturor
- Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, paanësisë, barazisë dhe sundimit të ligjit
- Ndjeshmëri, respekt dhe vlerësim pozitiv për njerëzit e tjerë
- Dëgjimi dhe vëzhgimi në një mënyrë jo-gjyqësore
- Hapja ndaj të tjerëve
- Tolerancë për paqartësi.

Proceset demokratike në klasë

Ka shumë situata të përditshme në të cilat duhet të bëhen zgjedhje dhe të merren vendime në klasë. Vendimet mund të merren në një mënyrë autoritare, nga mësimdhënësi ose nga nxënësit "më të fortë" ose "më të mirë", ose duke ndjekur procedurat demokratike. Një konflikt ose mosmarrëveshje mund të gjykohej nga më i forti, ose një zgjidhje fitues-fitues mund të kërkohet dhe arrihet përmes negociatave ose ndërmjetësimit. Rregullat e klasës mund të imponohen nga mësimdhënësi ose të miratohen në mënyrë demokratike përmes reflektimit dhe diskutimit me nxënësit. Nxënësit që kanë përgjegjësi specifike në klasë mund të emërohen nga mësimdhënësi ose të zgjedhen në mënyrë demokratike nga bashkëmoshatarët e tyre. Zëri i nxënësit mund të rritet përmes mjeteve të thjeshta të tilla si një "kuti sugjerimesh" (e cila gjithashtu mund të jetë një mjet në internet) i vendosur në mënyrë që çdo nxënës të mund të ndajë ide, ndoshta edhe në një mënyrë anonime. Duke vepruar kështu, mësimdhënësit kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e KKD-së së nxënësve duke krijuar dhe përdorur - në nivelin e klasës - procedurat që sigurojnë drejtësi, barazi dhe mosdiskriminim dhe gjithëpërfshirje, duke ofruar mundësi për të gjithë të rinjtë.

Proceset demokratike mund të zbatohen gjithashtu si pjesë e metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përdorura në një larmi lëndësh. Aktivitetet arsimore mund të përfshijnë simulime të zgjedhjeve, të shoqëruara ndoshta nga simulimi i një fushate politike, parlamente simuluese, gjykime simuluese, për-

caktimi dhe përdorimi i procedurave të drejta për marrjen e vendimeve për të zgjedhur midis opsioneve të ndryshme, luajtje-rolesh dhe simulime, duke përfshirë testimin e pozitive të autoritetit (një ditë si kryetar komune), e drejta për fjalën e lirë (simulimi i punës së gazetarëve), etj. Të gjitha këto metoda mund të shërbejnë për qëllime specifike të mësimnxënies në kurrikulën, ndërsa zhvillojnë edhe KKD-në.

Duke përjetuar procese demokratike, nxënësit do të zhvillojnë grupin e mëposhtëm të kompetencave:

- ▶ Vlerësimi i demokracisë, paanësisë, barazisë dhe sundimit të ligjit
- ▶ Përgjegjësia dhe mendësia qytetare
- ▶ Shkathtësitë komunikuese, bashkëpunuese dhe të zgjidhjeve të konflikteve
- ▶ Njohja dhe të kuptuarit kritik të demokracisë dhe politikës.

Mësimnxënia bashkëpunuese

Mësimdhënësi nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë nxënësit të shkojnë mirë me njëri-tjetrin vetëm duke u thënë atyre se "paragjykimi dhe diskriminimi janë gjëra të këqija". Studimet kanë demonstruar se si përdorimi i parimeve të bashkëpunimit për të paktën dy orë në ditë në shkollë do të zvogëlojë tensionet dhe agresivitetin midis nxënësve dhe të parandalojë dhunën.

Procesi i mësimnxënies strukturohet në përputhje me katër parime specifike të bashkëpunimit që ndihmojnë në shqyrtimin, vlerësimin dhe rritjen e aktiviteteve të mësimnxënies:

Ndërvlerësia pozitive: të gjithë duhet të kontribuojnë. Në një klasë pa struktura bashkëpunimi, një mësimdhënësi mund të ketë nxënës që punojnë vetëm në fletë pune individuale. Kur punojnë vetëm, në një mjedis konkurrues, nxënësit nuk angazhohen të ndihmojnë bashkëmoshatarët e tyre të bëjnë mirë. Në fakt, ata fshehurazi mund të shpresojnë që të tjerët të bëjnë dobët, kështu që duken mirë sipas krahasimit. Nxënësit që punojnë në një klasë duke përdorur strukturat bashkëpunuese e përfundojnë punën së bashku, secili me radhë për të zgjidhur një problem ndërsa partneri i tyre shërben si tutor. Ata kanë një qëllim të përbashkët për të arritur zgjidhje, përgjigje dhe shpjegime.

Llogaridhënia individuale: nuk fshihet! Në një strukturë bashkëpunuese, kur mësimdhënësi parashtron një pyetje ose jep një detyrë, secilit nxënës i jepet mundësia të marrë pjesë në përfundimin e detyrës, prandaj vlerësohet kontributi dhe përpjekja e nxënësit individual. Ky proces kërkon që çdo nxënës të përgatisë një performancë individuale publike në çdo rund. Angazhohen nxënësit që në ambiente të tjera nuk do të angazhoheshin.

Qasje e barabartë: pjesëmarrje jo-diskriminuese. Një mësimdhënësi ka prezantuar një temë dhe u kërkon nxënësve të "Diskutojnë çështjen në ekipë". Rezultati është i parashikueshëm: nxënësit më të artikuluar, ekstrovertë, ose nxënësit që ndjejnë fort rreth temës do të bëjnë pjesën më të madhe ose të gjithë bisedën. Mësimdhënësi që strukturon aktivitetin në mënyrë bashkëpunuese i mundëson secilit nxënës të kontribuojë në mënyrë të barabartë duke e lënë secilin nxënës ta përfaqësojë atë me radhë për një minutë ndërsa intervistohet nga shokët e tij të ekipit.

Ndërveprimi i njëkohshëm: i rritur sipas pjesëmarrjes së nxënësve. Kur një mësimdhënësi dëshiron që nxënësit të praktikojnë leximin kështu, një nga një, secili nxënës lexon me zë të lartë në mënyrë që mësimdhënësi të mund të vlerësojë dhe të tutorojë. Në një klasë prej 30 nxënësish të angazhuar në një periudhë prej 50 minutash, sasia maksimale e leximit me gojë në orë për secilin nxënës është më pak se dy minuta! Në një mjedis bashkëpunimi, mësimdhënësi çifton nxënësit, të cilët lexojnë me radhë me njëri-tjetrin. Secili nxënës mund të lexojë me zë të lartë për një kohë të konsiderueshme dhe mësimdhënësi ka rritur numrin e mundësive për vlerësim dhe tutorimin duke dëgjuar ekipet e vogla.

Duke u përfshirë në këto procese, nxënësit zhvillojnë grupin e mëposhtëm të kompetencave:

- ▶ Hapja ndaj besimeve dhe mendimeve të tjerëve
- ▶ Përgjegjësia për veprimet personale
- ▶ Shkathtësitë e mësimnxënies autonome
- ▶ Ndjeshmëria dhe ndërlidhja me mendimet, besimet dhe ndjenjat e tjerëve
- ▶ Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria
- ▶ Shkathtësitë e bashkëpunimit

- ▶ Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve
- ▶ Të kuptuarit kritik të vetvetes

Mësimnxënia e bazuar në projekt

Puna në projekt, ose mësimnxënia përmes projekteve, është një qasje pedagogjike veçanërisht e përshtatshme për zhvillimin e KKD-së sepse kontribuon në marrjen e një kombinimi të qëndrimeve, shkathtësive, njohurive dhe të kuptuarit kritik, si dhe në zhvillimin e vlerave. Mund të përdoret brenda një fushe specifike lëndore por është gjithashtu shumë e përshtatshme për një qasje ndërkurrikulare dhe për adresimin e çështjeve ndërsektoriale. Mësimnxënia e bazuar në projekt ofron potencialin e saj më të mirë kur zhvillohet në grupe të vogla dhe/ose nga një klasë e tërë. Zakonisht është strukturuar në një sekuençë hapash të shpërndarë në disa javë:

zgjedhja e një teme studimi ose e një pyetjeje të hapur dhe planifikimi i punës;
mbledhja e informacionit, organizimi i informacionit të mbledhur dhe marrja e vendimeve (që nënkupton përgjegjësinë individuale, bashkëpunimin në një grup dhe menaxhimin e ndryshimeve të mundshme të pikëpamjeve ose mosmarrëveshjeve);
përgatitja e produktit (i cili mund të marrë formë të ndryshme, të tilla si një poster, video, podcast, publikim, uebsajt, portfolio, tekst, performancë ose ngjarje);
prezantimi i produktit;
reflektimi mbi përvojën e mësimnxënies.

Në varësi të temës së zgjedhur, elementet e njohurive dhe të kuptuarit kritik të botës në modelin KKD gjithashtu mund të zhvillohen. Kur tema përfshin larmi gjuhësore dhe kulturore, procesi gjithashtu mund të stimulojë vlerësimin e diversitetit dhe hapjen ndaj diferencës dhe tjetërsisë. Roli i mësimdhënësit në një proces mësimor të bazuar në projekte është ai i një lehtësuesi të procesit mësimor. Nxënësit ndjekin udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi sa i përket hapave nëpër të cilat duhet të kalohet, por sa i përket përmbajtjes, vendimi duhet të mbetet në të shumtën me nxënësit. Instrumenti kryesor i mësimdhënësit është pyetja, jo përgjigjja. Parimet e përshkruara më sipër ende zbatohen dhe mësimdhënësi monitoron se si po zhvillohet bashkëpunimi në grupe. Mësimdhënësi duhet të inkurajojë nxënësit që të bashkëpunojnë, mbështesin njëri-tjetrin, t'i japin njëri-tjetrit informata kthyesë dhe të reflektojnë në atë që zbulojnë, si dhe në ndërveprimet e tyre.

Duke u përfshirë në këtë proces, pavarësisht nga tema e zgjedhur dhe përveç marrjes së njohurive dhe shkathtësive në lidhje me temën, zhvillon grupin e mëposhtëm të kompetencave:

- ▶ shkathtësitë e mësimnxënies autonome dhe vetë-efikasiteti: nxënësit vendosin të identifikojnë burimet e informacionit, të kontrollojnë besueshmërinë e tyre dhe të organizojnë vetë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe dizajnimin e produktit;
- ▶ shkathtësitë e të menduarit analitik dhe kritik: që lidhen me të kuptuarit, përpunimin dhe organizimin e informacionit, por edhe me reflektimin mbi përvojën e mësimnxënies;
- ▶ shkathtësitë e dëgjimit dhe vëzhgimit, veçanërisht në fazën e mbledhjes së informacionit;
- ▶ ndjeshmërinë, fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë, shkathtësitë e bashkëpunimit dhe shkathtësitë për zgjidhjen e konflikteve, si dhe respektin, përgjegjësinë dhe tolerancën ndaj paqartësisë;
- ▶ shkathtësitë e komunikimit: me gojë, me shkrim, të folurit në publik, plurilingualizmi;
- ▶ njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetvetes, të gjuhës dhe komunikimit veçanërisht gjatë fazës së reflektimit mbi përvojën e mësimnxënies.

Mësimnxënia e bazuar në shërbim

Mësimnxënia e bazuar në shërbim është gjithashtu një mënyrë efektive për të zhvilluar gamën e plotë të KKD-së sepse u jep nxënësve mundësi për të lidhur njohuritë dhe të kuptuarit kritik dhe shkathtësitë e marra në një mjedis klase me një veprim domethënës që synon një çështje të botës reale. Mësimnxënia e bazuar në shërbim është më shumë sesa shërbimi ndaj komunitetit. Kjo nënkupton ofrimin e një shërbimi ndaj komunitetit në kontekstin e një grupi të strukturuar hapash, në të cilin mësimdhënësi luan një rol të rëndësishëm si organizator dhe lehtësues, duke mbajtur një qasje të fortë me nxënësit në qendër dhe duke i fuqizuar nxënësit të marrin vendime dhe të veprojnë sipas vullnetit të tyre në bashkëpunim me bashkëmoshatarët.

Ndërsa mësimnxënja e bazuar në shërbim është një formë e të mësuarit të bazuar në projekte, një sekuençë e ngjashme e hapave do të shërbejë si referencë për procesin:

Vlerësimi i nevojave të komunitetit dhe identifikimi i përmirësimit ose ndryshimit që do të parashikohet;
Përgatitja e detyrës që do të ndërmerret duke mbledhur informacion, duke identifikuar dhe kontaktuar palët kryesore të interesit të komunitetit, duke analizuar opsionet për të adresuar çështjen dhe duke planifikuar ndërhyrjen;
Ndërmarrja e veprimeve duke u përfshirë në një aktivitet në shërbim të komunitetit i cili është domethënës për nxënësit dhe rrit mësimnxënien dhe zhvillimin e vlerave, qëndrimeve, shkathtësive dhe njohurive dhe të kuptuarit kritik. Veprimi mund të jetë i disa llojeve, duke përfshirë:
Prezantimin e punës dhe rezultateve përfundimtare të saj në komunitet dhe festimin e arritjeve;
Reflektimin mbi përvojën e mësimnxënies, mundësisht gjatë gjithë procesit, dhe vlerësimin e punës së bërë duke çuar në konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të aktiviteteve të ngjashme në të ardhmen.

Mësimnxënja efektive e bazuar në shërbim ka disa karakteristika të cilat kontribuojnë në zhvillimin e gamës së plotë të vlerave, qëndrimeve, shkathtësive dhe njohurive dhe të kuptuarit kritik të përfshirë në modelin KKD:

- ▶ shkathtësitë e mendësisë qytetare por edhe të përgjegjësisë, hapjes, ndjeshmërisë, vëzhgimit
- ▶ shkathtësitë e vetë-efikasitetit, e të menduarit analitik dhe kritik
- ▶ tolerancën e paqartësisë, shkathtësitë e mësimnxënies autonome dhe të menduarit kritik
- ▶ shkathtësitë e bashkëpunimit dhe zgjidhjeve të konflikteve, së bashku me fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë, dhe shkathtësitë e komunikimit
- ▶ njohuritë dhe të kuptuarit kritik të botës
- ▶ hapja ndaj tjetërsisë kulturore, shkathtësitë e dëgjimit, shkathtësitë gjuhësore dhe të komunikimit
- ▶ reflektimi mbi vlerat, dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetvetes

Metodat dhe qasjet e bazuara në përmbajtje

Zhvillimi i KKD-së nuk duhet të perceptohet si në konkurrencë me mësimin e shkathtësive themelore të gjuhës, matematikës, shkencës dhe të gjitha lëndëve të tjera shkollore, siç janë historia, gjeografia, edukata fizike dhe gjuhët moderne, për të përmendur vetëm disa. Është thelbësore t'u jepet fëmijëve dhe të rinjve të Evropës sot vlerat, qëndrimet, shkathtësitë, njohuritë dhe të kuptuarit kritik thelbësor për drejtimin e jetës së tyre si individualisht ashtu edhe kolektivisht në brezat që do të vijnë dhe për të shmangur përsëritjen e gabimeve dhe katastrofave të historisë. Mësimdhënësit mund të përdorin një gamë të gjerë mundësish për të përfshirë temat e rëndësishme për zhvillimin e KKD-së. Mënyra në të cilën do të zbatohen shembujt më poshtë mund të ndryshojë në varësi të moshës, nivelit të klasës dhe preferencave të nxënësve, si dhe nga konteksti i klasës.

Përdorimi i kurrikulës ekzistuese - brenda fushave lëndore

Të mësuarat në një mënyrë të vetëdijshme dhe të qëllimshme, të gjitha lëndët, brenda kurrikulës së tyre ekzistuese, mund të mbajnë aktivitete mësimore që mësojnë vlerat, qëndrimet, shkathtësitë dhe njohuritë dhe të kuptuarit kritik që nxënësit kanë nevojë për të qenë në gjendje të kontribuojnë në një kulturë demokratike. Tundimi për të "spërkatur" mësimin për KKD këtu dhe atje, me disa orë në vit kushtuar temave të tilla si kompetenca ndërkulturore ose qytetaria demokratike, mund të ketë pasojën negative të një sipërfaqësie të pashmangshme që errëson dhe shpërndan mesazhet thelbësisht të rëndësishme. Një qasje e parashikueshme është mësimi ekipor dhe zhvillimi i proceseve për të mbuluar modelin KKD përgjatë kurrikulës dhe në kryqëzimin e kurrikulës specifike për lëndët.

Si fillim, të gjitha lëndët shkollore mund të përdorin mirë akullthyesit e shkurtër, teknikat e grupimit dhe aktivitetet e tjera të ndërtimit të ekipit dhe vlerësimit për të siguruar që klasa të bëhet një komunitet mbështetës i nxënësve që janë gjithnjë e më të motivuar të mësojnë së bashku dhe të kontribuojnë, dhe që i besojnë njëri-tjetrit dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë.

Mësimdhënësit mund të fitojnë metoda për gjetjen e mundësive në kurrikulën ekzistuese. Arsimiti ndërkulturore, arsimimi për qytetarinë demokratike dhe arsimimi për të Drejtat e Njeriut, për shembull, mund të trajtohet brenda lëndëve të caktuara si historia, studime shoqërore dhe qytetare, por të gjitha lëndët shkollore mund të mbështesin zhvillimin e KKD-së, përfshirë gjuhën dhe letërsinë, matematikën, shkencën, historinë, gjeografinë, artin, dramën, gjuhët moderne, edukatën fizike, muzikën, ose teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Mësimdhënia ekipore dhe qasjet kurrikulare të integruara

Përveç asaj që çdo mësimdhënës mund të bëjë në kontekstin e një lënde specifike, bashkëpunimi midis mësimdhënësve të disa lëndëve mund të çojë në rezultate përfundimtare shtesë të vlefshme dhe efektive për zhvillimin e KKD-së. Ky bashkëpunim mund të jetë midis disa mësimdhënësve që punojnë me të njëjtën klasë, të cilët bashkërendojnë ndërhyrjen e tyre për të rritur KKD-në, por mund të jetë edhe midis mësimdhënësve që punojnë me klasa të ndryshme, të cilët mbështeten për t'u angazhuar në një partneritet dhe për të bashkëpunuar në aktivitetet mësimore që rezultojnë në zhvillimin e KKD-së.

Mësimdhënësit që punojnë me të njëjtën klasë mund të planifikojnë mësimdhënien e tyre së bashku në mënyrë që të sigurojnë që ata plotësojnë njëri-tjetrin në mbulimin e të gjitha elementeve të KKD-së, duke çuar në një përparim gradual të klasës në të gjitha aspektet, në mënyrë që të shmangin mbivendosjen dhe anashkalimin e elementeve të KKD-së. Ata gjithashtu mund të planifikojnë së bashku aktivitete më të mëdha mësimore të bazuara në projekte ose të mbulojnë, nga këndvështrimi i disiplinave të ndryshme për një periudhë më të gjatë kohore, tema transversale veçanërisht të rëndësishme për KKD-në, të tilla si të drejtat e njeriut, barazia gjinore, zhvillimi i qëndrueshëm, diversiteti sociokulturore dhe gjuhësor, parandalimi i diskriminimit dhe dhunës, etj.

Adresimi i “kurrikulës së fshehur”

Kurrikula e fshehur është shumë shpesh një status quo e padiskutueshme. Meqenëse Korniza bazohet në tri parimet e transparencës, koherencës dhe gjithëpërfshirjes dhe merr një perspektivë holistike të proceseve demokratike të mësimnxënies, është e rëndësishme që shkollat të shikojnë praktikën dhe mesazhet e tyre të fshehura dhe të harmonizojnë karakterin e shkollës me vlerat dhe qëndrimet e KKD-së.

Asgjë që mëson njeriu nuk është konotacion shoqëror. Paragjykimi gjinor, paragjykimi etnik dhe racor dhe mbizotërimi kulturor janë sëmundjet që gjenden më shpesh në kurrikulë dhe në përdorimin e saj në shkolla.

Mësimdhënësit duhet të vetëdijesohen dhe të marrin një qasje aktive në zbulimin e mësimëve të paqëllimta që mësohen në mjedisin e tyre. Edukatorët mund të priren të zgjedhin burime nga një burim i kufizuar burimesh, duke forcuar kështu pabarazitë shoqërore ose dominimin kulturor, si dhe stereotipet dhe diskriminimin.

Shumë mësimdhënës të matematikës dhe shkencave, për shembull, këmbëngulin se ajo që ata mësojnë është pa konotacione shoqërore. Nxënësve u jepen “probleme” matematikore për të zgjidhur të cilat rrallë lidhen me ndonjë gjë nga jeta reale. Rezultati i mesazheve të tilla të fshehura ose të nënkuptuara, dhe ndoshta të paqëllimshme, është që një numër nxënësish ngelin duke menduar se përmbajtja është e parëndësishme për jetën e tyre. Ata mund të humbin interesimin jo vetëm për punën, por edhe për matematikën në tërësi, pasi duket se nuk ka asnjë lidhje me realitetin tonë. Shumë studime argumentojnë se vendosja e matematikës përsëri në një kontekst shoqëror është një mënyrë për t'iu kundërvënë këtij lloji të “kurrikulës së fshehur”.

Një mënyrë tjetër e kontrollit të mesazheve të nënkuptuara të kurrikulës së fshehur është t'i kushtohet vëmendje e madhe burimeve dhe ilustrimeve që përdoren në materiale. Për shembull, nëse orët e letërsisë nuk përfshijnë kurrë autorë nga sfera të ndryshme të jetës dhe vende gjeografike, ose nëse librat e kurseve të gjuhëve përmbajnë vetëm fotografi dhe histori të familjeve të bardha të klasës së mesme që vizitojnë pamjet turistike, atëherë mund të konsiderohet nëse nxënësit po i nënshtrohen një kurrikuli, dhe nëse përmes strukturave të pushtetit të dijes dhe kulturës, mësimdhënësit detyrohen të vazhdojnë praktikën diskriminuese.

Përdorimi i përshkruesve të kompetencave

Në hartimin e mësimëve ose aktiviteteve që përqendrohen si në proces, ashtu edhe në përmbajtje, mësimdhënësit kanë në dispozicion një grup përshkruesish të kompetencave të vlefshme dhe të shkallëzuara. Mënyrat e përdorimit të përshkruesve dhe keqpërdorimet e mundshme për të shmangur përshkruhen në dokumentin kryesor të Kornizës dhe më shumë detaje dhe lista e përshkruesve janë paraqitur në Vëllimin 2. Këto janë veçanërisht të rëndësishme për pedagogjinë e KKD-në sepse përshkruesit formulohen duke përdorur gjuhën e rezultateve përfundimtare të mësimnxënies

dhe mund të merren si referencë në përcaktimin e rezultateve përfundimtare të mësimnxënies të aktiviteteve të ndryshme të mësimnxënies. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit se në shumicën e rasteve përshkruesit që korrespondojnë me një grup kompetencash duhet të kombinohen në zhvillimin e një aktiviteti mësimor.

REFLEKTIMI I ROLIT TË TRAJNERËVE

Nëse mësimdhënësit në shkolla janë aktorët më të rëndësishëm në ndikimin e cilësisë së proceseve arsimore të nxënësve, mund të supozohet se edukatorët mësimdhënës (para ose gjatë shërbimit) kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e mësimnxënies së mësimdhënësve të nxënësve. Kërkesat e larta i parashtrohen udhëheqjes dhe menaxhimit për të mundësuar një koordinim koherent të (nën)ekspertizës. Një listë e parë e kësaj (nën)ekspertize mund të përfshijë kompetencat e mëposhtme që do të merren nga edukatorët mësimdhënës:


- ▶ kompetencat e mësimdhënies e rendit të parë (mësimdhënia e nxënësve);
- ▶ kompetencat e mësimdhënies e rendit të dytë (mësimdhënie për mësimdhënie);
- ▶ zhvillimi i njohurive;
- ▶ kompetencat sistemike;
- ▶ kompetencat transversale;
- ▶ kompetencat e udhëheqjes;
- ▶ kompetencat në bashkëpunim (ndërdisiplinor).

Përvoja tregon se një listë e thjeshtë e kompetencave nuk kontribuon (akoma) në performancën e dëshirueshme. Edukatorët mësimdhënës duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që të përfshihen palët e tjera të interesit. Si trajner është me rëndësi qendrore të pyesni veten dhe të mos punoni në izolim:

- ▶ Si rrjetëzoheni me kolegët?
- ▶ Si i mbani të informuar për zhvillimet e fundit në ministri?
- ▶ Me cilët profesionistë (këtu për çështje të gjithëpërfshirjes) jeni në kontakt?
- ▶ Çfarë kontakti keni me drejtorët?

COMPETENCES FOR DEMOCRATIC CULTURE

20 Competences for Democratic Culture and their matching
135 Descriptors to help you detect the strength and weakness
of the democratic culture in schools and elsewhere.



Kultura e demokracisë: Posteri i kopshtit

Më shumë informata
www.coe.int/education

Kontakti

Zyra e Këshillit të Evropës
17/18 Rruga Bedri Pejani
10000 Prishtinë

Email:
coe.pristina@coe.int
education.pristina@coe.int
Tel: 383 (0) 38 407 750
Faksi: +383 (0) 38 407 751

Prens 095521

SQL

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

<http://europa.eu>

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe